

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 16 QERSHOR 0222

Vendimi Nr. 2022-026

Zëvendësimi i Sekretares Fjolla Ibishi gjatë pushimit të Lehonisë

- Në ndërlidhje me vendimin 2022-022 të bordit, dhe pas refuzimit të pranuar nga Komisionerja Benita Selmanaj për tu angazhuar si zëvendësuese e Sekretares gjatë pushimit të saj të lehonisë, bordi me shumicë votash merr vendim që për çështjen në fjalë të kontaktohen persona brenda komunitetit të tenisit ose të hapët një konkurs i jashtëm.

Vendimi Nr. 2022-027

European Juniors Championships 2022 – U18 / Zvicër

- Në ndërlidhje me vendimin 2022- K03, bordi me shumicë votash aprovon propozimin që shoqërues e tenistes Vesa Gjinaj në EJCH 2022- U18 të jetë trajneri Fatos Bejta.
- FTK do të i rimburojë shpenzimet e z. Bejta sipas rregullores 03 për financat, procedurat dhe rregullat.

Vendimi Nr. 2022-028

Ndihmë financiare - KT Rilindja

- Miratohet me shumicë votash kërkesa e KT Rilindja për ndihmë financiare në vlerë 3,000 EUR si pasojë e humbjeve gjatë sezonit dimëror me problemet e vendosjes së balonit.
- Mjetet do të kalojnë në KT Rilindja posa të krijohen mundësitë financiare.

Vendimi Nr. 2022-029

Rimburosimi i shpenzimeve të Vesa Gjinaj në Antalya

- Bordi me shumicë votash aprovon të i mbulojë shpenzimet e Vesa Gjinaj për pjesëmarrjen e saj në turnet në Antalya si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve nga Federata Turke e Tenisit të cilët janë zotuar që shpenzimet e akomodimit do të mbuloohen nga ta.
- FTK do të mbulojë këto shpenzime sipas rregullores 03 për financa, procedura dhe rregulla.

Vendimi Nr. 2022-030

Komisioni Disiplinor për trajtimin e ankesave

- Bordi me shumicë votash dhe në përputhje me pikën 6.6. të statutit të FTK-së, propozon komisionin disiplinor për trajtimin e ankesave të pranuar.
- Në komision propozon: 1. Shkelzen Domi – Kryesues i Komisionit 2. Benita Selmanaj– Anëtar i Komisionit. Anëtari i tretë do të propozohet së shpejti online.
- Të lartpërmendurit do të kontaktohen nga administrata për të konfirmuar pjesëmarrjen në këtë komision.

Vendimi Nr. 2022-031

Përkrahja e z. Senad Jusufi për certifikim si trajner mental

- Miratohet kërkesa e z. Senad Jusufit për përkrahje financiare për pjesëmarrje në Kursin Certifikues për Trajner Mental.
- Bordi me shumicë votash merr vendim që z. Jusufi të gëzojë përkrahje financiare për pjesëmarrje dhe certifikim.
- Kursi do të mbahet nga ekspertë Kroat dhe kostoja e saj për 3 nivele mbërrin vlerën 1,400 EUR.